

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"EAST WEB SERVICES" SHPK**

KREU I

Dispozita te Pergjithshme

Sot, më datën 31.08.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) personi i mëposhtëm:

- **Emirjon GËRXHI**, atësia Ibrahim, i datëlindjes 10.11.1979, lindur në Berat, dhe banues në Tiranë, Rr. "Medar Shtylla" Kompleksi Kika 1, Shkala 4, Hyrja nr. 9, shtetas Shqipëtar ,madhor e me zotësinë e plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së indentitetit me nr. **028603054**;

në cilësinë e "Ortakut Themelues", me vullnet të lirë, të plotë e të singertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901 datë 04.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", vendosëm të themelojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emertimin **"EAST WEB SERVICES" SHPK**.

KREU II

Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore

Neni 1

Emri

- 1.1 Shoqëria është e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" dhe mban emrin **"EAST WEB SERVICES" SHPK**.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash,në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

Neni 2

Objekti

Shoqëria " **EAST WEB SERVICES" SHPK** do të ketë objekt veprimtarie:

* Te ofroje sherbime ne fushen e biznesit dhe menaxhimit te sherbimeve te konsulences. Të veprorë si keshilltar biznesi dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe lidhet me aktivitetin e biznesit. Te ofroje sherbime call centre, sherbime telefonike inbound dhe outbound. * Te ndermarre veprimtari tregtare ose biznesi, qe sipas gjykimit te organit administrativ, mund te jete i vlefshem per tu kryer nga shoqëria, në lidhje me ose si ndihmese e veprimtarive te siperpermendura ose e veprimtarise se pergjithshme te shoqërise ose degeve te saj. * Të blejë, te marrë me qera apo të shkëmbeje, të fitoje apo të marrë dhe të regjistrojë çdo pasuri apo interesa ne pasuri te paluajtshme, si toka, ndërtesa, te drejttat e servituteve, privilegjet, koncesione, të drejttat e patentës, licencave, proceset e fshehta, makineri, bimëve aksioneve, dhe çdo te drejte personale apo reale, qe mund te konsiderohen te nevojshme per



objektin e veprimtarise se shoqerise. * Te marre hua ose te rrise apo te siguroje kthimin e parave qe lidhen me veprimtarine e shoqerise, si dhe per qellime te sigurimit te parave per tu bere ortak ne ndonje shoqeri ndertimit. * Te investoje parate e shoqerise qe nuk jane menjehere te kerkueshme, per qellime te veprimtarise se shoqerise, ose te investoje ne letra me vlere, ne menyren dhe formen qe mund te caktohet kohe pas kohe. Objekti i veprimtaris nuk eshte shtrerrues.

Neni 3

Kohezgjatja

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqeria "EAST WEB SERVICES" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKR-se.

Neni 4

Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Pjeter Bogdani, Pallati nr.4, Shkalla 2, Hyrja 5, Tirane,
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijojte dhe nape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

KREU III

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte **100.000 Lek** (njqind mije lek), i barabarte me l(nje) kuote. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesemarrja e Ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tyre dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne" menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	Emirjon GERXHI	1	100.000	100%
	Totali	1	100.000	100 %

- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakeve te shoqerise.



Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Transferimi i Kuotave

7.1 Transferimi (përfshirë shitje dhe ose dhurimin dhe ose çedimin dhe ose kalimin) të kuotave të shoqërisë tek palë të treta i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë ekzistues, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të parashikuara në nenin 7.2 më poshtë.

7.2 Në rast se një ortak (këtej e tutje i quajtur Ofruesi) kërkon të transferojë disa ose të gjitha kuotat ose kontributet e zotëruara prej tij në shoqëri, ortakët e tjerë (këtej e tutje të quajtur Ortakët e tjerë) gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat që ofrohen për transferim (këtej e tutje të quajtur Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:

- a. Ofruesi do të dërgojë fillimisht ortakëve të tjerë ekzistues një njoftim me shkrim (postë rekomandë) ku të përcaktohet numri i kuotave të ofruara, si dhe emimin e kuotave të ofruara, emrin e blerësit dhe kushtet e tjera kontraktuale të transferimit (këtej e tutje referuar si oferta) duke ftuar së pari ortakët ekzistues të blejnë keto kuota të ofruara.
- b. Ortakët e tjerë kanë të drejtë të blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertës, në përpjestim me përqindjet e zotëruara, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati 30 ditor pas marrjes së njoftimit të ofruesit me postë - rekomandë.

7.3 Në rast se një apo disa nga ortakët ekzistues nuk përgjigjen gjatë afatit të mësipërme apo përgjigjen në mënyrë negative, atëherë ofruesi është i lirë në transferimin e kuotave në favor të palëve të treta pa kufizim, me kushte të njëjta si ato të parashikuara në ofertën e mësipërme.

7.4 Parashikimet sa më sipër nuk zbatohen në rastin kur kuotat transferohen ndërmjet ortakëve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur në vijë të drejtë të ortakëve ekzistues (fëmijë, bashkëshortë).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit



- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë nga shoqëria likuidimin e saj, në vlerë të përcaktuar nga ekspert perkates.

Kreu IV Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i Shoqërise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqërise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqërise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqërise;
 - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
 - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqërise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërise;
 - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
 - n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqërite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."



- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorancës sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me leter rekomandë me njoftim marrje të dërguar në adresën e ortakëve apo poste elektronike (email) (adresa të depozituara rregullisht nga ortakët pranë administratorit dhe email të pasqyruar në ekstraktin e shoqërisë në të dhënat vullnetare të tij të pakten 7 ditë përpara mbledhjes). Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblese duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të pakten 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedurë njoftimi që përshkruhet më sipër.

Neni 10


Kuorumi i nevojshëm

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve të zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qoftë dhe nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin e marrjes së vendimeve të jashtëzakonshme, që kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qoftë dhe nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të jashtëzakonshme me anë të votes pro të një shumice prej 3/4 të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese së përgjithshme rregullisht të mbledhur për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.



- 11.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marre vendime të zakonshme me anën e votes pro të shumices të ortakeve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese së përgjithshme, rregullisht të mbledhur, dhe vecanerisht mbi çeshtjet e mëposhtme:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4 Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 11.5 Çdo vendim i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në përputhje me nenin 90 të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 12


Votat e Ortakëve

- 12.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit



- 13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakeve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "EAST WEB SERVICES" SHPK:

Emirjon GËRXHI, atësia Ibrahim, i datëlindjes 10.11.1979, lindur në Berat, dhe banues në Tiranë, Rr. "Medar Shtylla" Kompleksi Kika 1, Shkala 4, Hyrja nr. 9, shtetas Shqipëtar, madhor e me zotësinë e plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së indentitetit me nr. 028603054, për një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.
- 14.2 Pa u kufizuar sa me sipër, në menyre të vecante, Administratori ka këto kompetenca:
- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë persa i përket administrimit të zakonshëm;
 - (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
 - (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
 - (iv) do të përgatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipoteke, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barrë mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuar shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
 - (v) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
 - (vi) do të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;
 - (vii) do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
 - (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;



- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xi) do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
- (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.
- (xiii) Do te administroje adresat dhe kontaktet e ortakeve (tel, email). Ne cdo rast ortaket jane te detyruar qe menjehere pas cdo azhornimi te kontakteve te tij (nr.tel, email, adrese shtepie) te njoftoje administratorin me shkrim, ne te kundert mban pergjegjesi per cdo dem te shkaktuar nga mosnjoftimi ne kohe.

Asambleja e pergjithshme, ne baze te njeh vendimi te marrë me shumicën e percaktuar sa me sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit per shoqerite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqerie, ne baze te kuorumit te kerkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.



- 16.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3 Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

Neni 18

Njoftimet

- 18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në



adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19

Të Ndryshme

- 19.1 Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vullnetin e saj.
- 19.2 Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4 Në fund të cdo viti financiar, Administratori barton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5 Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

Neni 20

Dispozita përfundimtare

- 20.1 Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilesuar të përcaktuar me sipër.
- 20.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortaket do të referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga palet pa asnjë rezervë.

ORTAKU THEMELUES

1. Emirjon GËRXHI,

